

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË

P. nr. 01/2010

01 Mars 2011

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË, me Gjyqtarën e EULEX-it Christine Lindemann-Proetel si Kryetare e Trupit Gjykses në rastin e veprës penale kundër:

ASLLAN PEÇI, i biri i Sahit Peçit dhe Halime Avdiut, i lindur më 16 Korrik 1943 në fshatin Rahove, Komuna e Mitrovicës, Shqipëtar i Kosovës, me banim në fshatin Rahove;


Sipas Nenit 397, Paragrafi (1) i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (“KPPK”), lëshon këtë:

AKTVENDIM

Përkthimi në gjuhën shqipe i Aktgjykimit P nr. 01/2010 të lëshuar më 14 Tetor 2010 do të korrigjohet si në vijim:

Në të gjitha vendet ku paraqitet termi në gjuhën shqipe “gërrshërë bujqësore” në përkthimin aktual në gjuhën shqipe, duhet të zëvendësohet me fjalën e gjuhës shqipe “kmesë”.

Aktgjykimi origjinal në gjuhën angleze i referohet vetëm fjalës “billhook” (e cila në gjuhën shqipe përkthehet me fjalën “kmesë”), dhe në asnjë vend nuk përmendet termi “agricultural scissors” (që në gjuhën shqipe përkthehet “gërrshërë bujqësore”).



Christine Lindemann-Proetel
Kryetare e Trupit Gjykses